



Ura e Bratajt gëzon statusin Monument Kulture i Kategorisë së parë (I) shpallur me nr. 1886, datë 10.06.1973.

Viti/koha e ndërtimit: Shek. XVII.

Ura e Bratajt ndodhet në fshatin Brataj të rrethit të Vlorës. Ajo është ndërtuar mbi lumin Shushicë. Në qendër ndodhet një hark i madh dhe në të dy anët ndodhen dy harqe më të vegjel, të mbështetur në masivin monolit të shkëmbit.

Ura e Bratajt është ura më e madhe e periudhës osmane, rreth 50m e gjatë, 4m e gjerë dhe arrin deri në 12m lartësi.

Monumentaliteti i saj qëndron në harmonizimin e elementëve arkitektonikë me peizazhin dhe terrenin shkëmbor, mbi të cilin është ndërtuar.













